

VENDIM
Nr. 123, datë 28.10.2013

PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES TË SHOQËRISË “ZALL HERR ENERGJI 2011” SHPK, SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE NGA HECET “CEKREZE 1” DHE “CEKREZE 2”

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “ll”, 9 dhe 39 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe neneve 7 e 8 të “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 28.10.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Zall Herr Energji 2011” sh.p.k., për kualifikimin e impiantit prodhues për hecet “Cekreze 1” dhe “Cekreze 2” si burim i rinovueshëm energjie, konstatoi se:

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “Zall Herr Energji 2011” sh.p.k., është konform “Rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, gerrat “a”, “b”, “c”, “d”

Përshkrimi i përgjithshëm i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

- Neni 7, pika 2, gerrat “a”, “b”, “c”, “d”

Dokumentacioni vijues grafik, korografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.

Ky dokumentacion është paraqitur në mënyrë korrekte.

- Neni 7 pika 3, gerrat “a”, “b”, “c”

Përshkrimi i centralit.

Ky dokumentacion është dhënë i saktë dhe i plotë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të kualifikojë impiantin prodhues të shoqërisë “Zall Herr Energji 2011” sh.p.k., si burim i rinovueshëm energjie nga hecet “Cekreze 1” dhe “Cekreze 2”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit Ahmeti